



Një projekt i cili synon të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të organizatave të Shoqërisë Civile Shqiptare për të faktorizuar e adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore në vend.

Çështjet mjedisore në vend, fokus i projekteve të mbështetura nga Green-AL

Projekti ka filluar në Janar 2021 dhe do të zgjasë deri në Dhjetor 2023. Përgjatë tre viteve të zbatimit, ai do të krijojë mundësi të reja bashkëpunimi ndërmjet organizatave dhe grupeve komunitare për të advokuar në proceset e hartimit të politikave mjedisore si dhe të prezantojë modele inovative në menaxhimin mjedisor. Buxheti total i këtij projekti është 1.223.100 euro nga të cilat 785.000 euro u vunë në dispozicion

të organizatave të shoqërisë civile, nëpërmjet skemës së granteve.

Green-AL zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat CISP Sviluppo dei Popoli, VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo me mbështetjen e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA).



Katër takime informuese, prezantohet projekti Green-AL

Gjatë fazës së parë u mbajtën takimet informuese në katër rajonet e Shqipërisë, referuar ndarjes territoriale të Green-AL. Këto takime shërbyen për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me projektin dhe objektivat e tij, si dhe për të kontaktuar një numër të madh aktorësh si organizata të shoqërisë civile, institucione publike,

përfaqësues të biznesit dhe komunitetin e gjerë. Në katër takimet, ku morën pjesë 184 persona, u diskutua me palët e interesuara për çështjet më urgjente mjedisore në vend si dhe fushat prioritare të cilat mund të ngrihen dhe trajtohen në dy thirrjet për projekt propozime.



Procesi i vlerësimit / Green-AL identifikon problematikat mjedisore dhe të barazisë gjinore në katër rajonet e Shqipërisë

Partnerët e projektit Green-AL gjatë muajit shkurt nisën një proces vlerësimi të nevojave

të fokusuar në problematikat mjedisore dhe të barazisë gjinore. Ky proces ndihmoi në

krijimin e një pamje të qartë të kapaciteteve, fushave të ndërhyrjes dhe shtrirjes së organizatave dhe aktivistëve në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Përmes një pyetësori të plotësuar nga rreth 200 organizata të shoqërisë civile si dhe individë, u identifikuan problemet mjedisore dhe barazisë gjinore në këtë sektor për katër rajonet e Shqipërisë si dhe aspektet e kapaciteteve njerëzore, materiale, financiare dhe teknike të

organizatave. Referuar të dhënave të mbledhura rezultoi se në rajonin veri-lindor dhe atë jugor ka një përfshirje të ulët të elementit të barazisë gjinore dhe të bashkëpunimit me organizatat për fuqizimin e grave në proceset e zbatimit të projekteve me fokus mjedisin.

Procesi synoi edhe vlerësimin e mjedisit dhe kontekstit socio-ekonomik, politiko-kulturor, ligjor brenda të cilit organizatat e ndryshme të shoqërisë civile dhe aktivistët operojnë.



PËRFSHIRJA DHE ROLI I GRAVE NË MBROJTJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI

Në përballjen me ndryshimet klimatike barazia gjinore është një nga sfidat kryesore. Përfshirja e grave dhe vajzave në politikat, programet dhe organizata kontribuon pozitivisht në arritjen e qëllimeve mjedisore dhe rritjen e nivelit të ripërtëritjes ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Niveli i balancit gjinor në organizata mjedisore në katër rajonet:




Pozicionet që mbajnë më së shumti gratë në organizatat mjedisore në katër rajonet:



5 faktorët kryesorë që ndikojnë në nivelin e përfshirjes së grave në sektorin e mjedisit:



Niveli i bashkëpunimit të organizatave mjedisore me organizatat e tjera për fuqizimin e grave në shoqëri.



Burimi: Të dhënat e mësipërme mbi perceptimin lidhur me përfshirjen dhe rolin e grave në mbrojtjen e mjedisit në rajonet e Shqipërisë janë mbledhur nga pyetësori i zhvilluar me organizatat e shoqërisë civile që merren me mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri si pjesë e fazës së Vlerësimit të Nevojave në kuadër të projektit Green-AL "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri".



Procesi i Inkubimit / 40 trajnime për organizatat e shoqërisë civile në katër rajonet në vend

40 trajnime tematike, administrative dhe me bazë gjinore kanë filluar të organizohen si pjesë e procesit të Inkubimit nga projekti Green-AL. Me 10 trajnime të planifikuara për rajon, partnerët e projektit Green-AL do t'u mundësojë organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin si dhe të

zhvillojnë kapacitet e njohuritë e tyre në fushën e mjedisit dhe çështjeve gjinore të cilat lidhen me këtë sektor.

Në dy trajnimet e para me temë Menaxhimi i Ciklit të Projektit dhe Menaxhimi Financiar, organizatat e rajonit qendror, veri-lindor, veri-perëndimor, dhe jugor u njohën me



hapat kryesore që duhen ndjekur gjatë zhvillimit dhe implementimit të një projekti si dhe mënyrën e buxhetimit të një projekt-propozimi sipas kriterëve kryesore. Partnerët e Green-AL zhvilluan edhe trajnime tematike me fokus

qëndrueshmërinë e pyjeve, advokimin, lobimin dhe mbledhjen e fondeve, aftësinë ripërtëritëse (*resilience*) dhe kuadrin ligjor e institucional për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive në Shqipëri.



22 projekte fituese në thirrjen e parë për Grantet e Iniciativës dhe Partneritetit

Partnerët e Green-AL hapën më 14 korrik 2021 thirrjen e parë të skemës së granteve e ndarë në dy kategori kryesore, grantet e Iniciativës dhe grantet e Partneritetit, për të kontribuar në adresimin e sfidave mjedisore në vend.


Moduli i granteve të Iniciativës ka si qëllim fuqizimin e organizatave të reja për të ngritur çështje mjedisore të cilat i vijnë në ndihmë komunitetit lokal. Ndërkohë, moduli i granteve të Partneritetit synon të nxisë bashkëpunimin ndërmjet organizatave mjedisore dhe grupe të tjera të interesit si institucionet publike, grupet komunitare

dhe bizneset, për të ngritur dhe trajtuar problemet mjedisore në nivel lokal dhe rajonal.

Në këtë thirrje aplikuan 77 organizata mjedisore nga gjithë vendi ndërsa u përzgjodhën 22 projekte fituese të cilat ndikojnë në përmirësimin e gjendjes mjedisore në zonat ku zbatohen.

Disa nga tematikat e projekteve fituese në thirrjen e parë fokusohen në ndërgjegjësimin dhe edukimin mjedisor, menaxhimin e ujërave të ndotura, riciklimin, promovimin e ekomuzeve dhe konceptit të





qyteteve ekologjike, pastrimin e ujërave detare, mbetjeve si dhe rehabilitimin ndaj impaktit të guroreve.

Partnerët e projektit Green-AL me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga

Ambasada Suedeze në Tiranë dhe Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Tiranë zhvilluan edhe ceremoninë e nënshkrimit të kontratave me fituesit e granteve.

Histori nga fituesit e granteve

Projekt në rajonin Veri - Perëndimor

Nxënësit e shkollave "Hamdi Bushati" dhe "Dëshmorët e Rrencit" në Shkodër kanë filluar të njihen me konceptet bazë të mbetjeve ushqimore. Këto njohuri ata po i zhvillojnë edhe në praktikë falë projektit "Të Rinjtë Shkodranë Kundër Humbjeve Ushqimore", i zbatuar nga organizata WellPoint me mbështetjen e Green-AL. Në tokën laborator të projektit, është krijuar një

hapësirë e dedikuar mbetjeve urbane ushqimore me qëllim që nxënësit të studiojnë nga afër procesin e dekompozimit të mbetjeve dhe ndikimit që kanë llojet e ndryshme të tyre në klimë dhe në mjedisin në tërësi.

Toka laborator u vizitua edhe nga përfaqësues të Agjencisë Ndërkombëtare



Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Tiranë, dhe përfaqësuesve të VIS Albania, ku u njohën me punën e deritanishme të

organizatës dhe kompostimin e mbetjeve të ndryshme të realizuar nga të rinjtë e Shkodrës.

Projekt në rajonin Qendror



Organizata fituese në modulin e granteve të Partneriteti, EcoPartners për Zhvillim të Qëndrueshëm prezantoi në Roskovec, projektin "Fuqizimi i zërit të shoqërisë civile dhe komunitetit për një mjedis më të shëndetshëm në Patos dhe Marinëz". Fokus i këtij projekti është fuqizimi i komunitetit vulnerabël të zonave naftëmbajtëse me informacione mbi situatën mjedisore dhe sociale.

Në kuadër të aktiviteteve, ekipi i punës zhvilloi edhe një takim të hapur në Bashkinë Patos me pjesëmarrjen e kryetares znj. Rajmonda Balilaj, përfaqësuesve të komunitetit, shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe të rinjve, ku u diskutua për projektin dhe fillimin e një procesi vlerësimi të situatës socio-ekonomike në nivel lokal.

Projekt në rajonin Veri - Lindor

Problematikat negative mjedisore dhe ekonomiko-sociale, që shkaktohen nga ndërtimi i HEC-it Madhesh në lumin Lundër fshati Madhesh po adresohen përmes projektit "Angazhimit i komuniteti i për Mbrojtjen e Burimeve Ujore të Fshatit Madhesh, Bashkia Mat". Organizata Miqësia Ulëz, fituese e granteve të Iniciativës synon që përgjatë zbatimit të këtij projekti të përmirësoj cilësinë e jetës, përmes mbrojtjes së burimeve ujore, vlerësimit të parametrave mjedisore dhe vlerave të biodiversitetit (flora, fauna, uji, toka) për banorët e fshatit. Së bashku me ekspertë të fushës, ekipi i projektit ka zhvilluar vizita në terren dhe takime ndërgjegjësuese me komunitetin për rëndësinë e mbrojtjes së sipërfaqeve ujore nga ndërtimi i hidrocentraleve.




Projekt në rajonin Jugor

Krijimi i ekomuzeumit të Zvërnecit si një monument ku do të ndërthuret historia, trashëgimia kulturore e zonës flora dhe

fauna po bëhet e mundur përmes mbështetjes së Green-AL. Organizatat fituese në modulin e granteve të

Partneritetit, Shoqata CERCİ dhe Vjosa Explorer, kanë zhvilluar vizita në terren për studimin specieve të zonës dhe ambienteve të jashtme tek bunkerë-galeritë në veriperëndim të ishullit të Shën Mërisë në Zvërnec. Gjithashtu, si pjesë e aktiviteteve të parashikuara për projektin janë zhvilluar edhe takime me ekspertë mjedisor dhe njohës të zonës për të identifikuar ndërhyrjet që duhet të zhvillohen duke marrë parasysh agjentët atmosferikë dhe erozionin e zonës. Ky ekomuzeum i munguar do të jetë një hapësirë e re për komunitetin, nxënësit dhe turistët në qytetin e Vlorës.



Projekti Green-AL "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat CISP Sviluppo dei Popoli, VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.